






DITARI MUJOR

KORRIK 2022



Praktikat profesionale në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit, Elbasan, për të tretin vit rradhazi, ka mirëpritur të rinjtë përfitues të programit të nxitjes së punësimit. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, përmes praktikave profesionale, u jep mundësinë të gjithë të rinjve nga 21 deri në 26 vjeç të cilët kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve "Bachelor", të zhvillojnë praktika pune. Qëllimi i këtij program është të garantojë një tranzicion të shpejtë të të rinjve në tregun e punës, fitimin e një përvojë kualifikuese, zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale.



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", pjesë e Forumit të Liderave të Oxfordit, Britani e Madhe



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", bëhet pjesë e Forumit të Liderave të Oxfordit. Në një ceremoni të organizuar në kuadër të Samitit të Liderave, Universiteti i Elbasanit, prezantoi strategjinë e zhvillimit dhe ndërkombëtarizimit. Ky event shënon një hap shumë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave ndërkombëtare institucionale me në qendër studentët dhe kërkimin shkencor.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", pjesë e projektit të ri nga EIT



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", do të marrë pjesë në një projekt të ri të quajtur HEI4FUTURE. Projekti synon të kthejë kapacitetet teknologjike në aftësi të reja, të gjenerojë produkte dhe shërbime të reja duke punuar së bashku me industri të ndryshme. HEI4Future do të arrihet përmes një game të gjerë aktivitetesh për të promovuar sipërmarrjen (punëtori trajnuese për mësues dhe personel arsimor, studentë, menaxherë dhe sipërmarrës të rinj), seminare për ndërtimin e ekipit, mbështetje të drejtpërdrejtë përmes rrjeteve të mentorimit ose trajnerëve dhe programeve të lëvizshmërisë për të promovuar sinergjitë ndërmjet ekepeve të sipërmarrësve. Projekti do të marrë financim nga Iniciativa e IAL EIT: Ngritja e Kapaciteteve Inovative për Arsimin e Lartë. Kjo nismë e Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) synon të rrisë kapacitetin sipërmarrës dhe inovativ

të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në të gjithë Evropën. Si pjesë e këtij projekti, ne do të punojmë së bashku me partnerët e mëposhtëm:

- UNIVERSITETI I VIGO-s – SPANJË – UDHËHEQËSI I PROJEKTIT
- UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" – SHQIPËRI
- UNIVERSITETI I LISBONËS – PORTUGALI
- FONDAZIONI POLITEKNIK I MILANO-s – ITALI
- KOLEGJI UNIVERSITAR I DANIMARKËS VERIORE – DANIMARKA
- POWERHUB, Z.U. - REPUBLIKA ÇEKE

Sipas Iniciativës së IAL | EIT, projekti do të marrë financim prej 55,000 € dhe do të zgjasë deri në dhjetor 2022, me mundësi të zgjatjes edhe për 18 muaj të tjerë.

Junior Achievement of Albania, zhvillon aktivitetin "Klubi i Debatit"

Në kuadër të programit të debatit "Debating Economics" të Junior Achievement of Albania, studentët të Klubeve të Debatit pranë 6 Fakulteteve të Gjuhës së Huaj pjesë të projektit "3E-English-Entrepreneurship-Employability", që po zbatohet me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Tiranë, u bënë pjesë e aktivitetit të Debatit mes Universiteteve, të zhvilluar në Vlorë më datë 21 Korrik. Secili klub u përfaqësua nga 2 anëtarë, të cilët debatuan me kolegë të tyre nga Universitetet e tjera pjesëmarrëse në aktivitet. 6 Universitete partnere të JAA pjesë e aktivitetit ishin; Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Tiranës, Universiteti "Ismail Qemali", Universiteti "Eqerem Çabej", Universiteti i El "Aleksandër Xhuvani" dhe Universiteti "Fan S.Noli".

Debati mes Universiteteve synon të promovojë dhe rrisë kapacitetet debatuuese të pjesëmarrësve në klubet e debatit të Universiteteve partnere të Programit "Debating Economics" nga JAA, si dhe të nxisë mendimin kritik dhe komunikimin publik të studentëve pjesëmarrës. Tre raunde debati përbënin strukturën kryesore të këtij aktiviteti, ku raundi final vuri përballë skudrën debatuuese të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universitetit të Tiranës dhe atë të Universitetit "Eqerem Çabej" Gjirokastrë. Skuadra fituese e raundit final dhe e gjithë aktivitetit të Debatit mes Universiteteve u shpall skuadra debatuuese e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës.



"Të rinjtë përballë lajmeve të rreme".



Pogradeci ka qenë destinacioni, ku për 3 ditë rradhazi, u zhvillua kampi i të rinjve ku në fokus ishte "Të rinjtë përballë lajmeve të rreme". Studentët të gazetarisë nga universitetet e Tiranës, Shkodrës dhe Elbasanit, gazetarë të rinj nga Ballkani Perëndimor dhe gazetarë profesionistë diskutuan e punuan së bashku se si të dallojnë e luftojnë lajmet e rreme dhe dizinformimin. Ata shkruajtën artikuj duke përdorur mjetet e vërtetimit të informacionit, si dhe u njohën më mirë me angazhimet e OSBE-së për promovimin e lirisë së medias, të paqes dhe të sigurisë në rajon. Kampi u zhvillua në vijim të edicionit Shtigje Rinore 2021, gjatë të cilit gazetarë të rinj premtues nga rajoni u mblodhën në Tiranë dhe hartuan një dokument të titulluar Platforma Mediatike e Tiranës, ku nxorën në pah dhe bënë rekomandime për trajtimin e disa prej çështjeve më të ngushtme në media. Me mbështetjen e vyer të Agjencisë Austriake të Zhvillimit, ambasadës së Greqisë në Shqipëri dhe Misionit të Përhershëm të Italisë në OSBE, përmes këtij kampi, Prezenca e OSBE-së vijon shkëmbimet mes gazetarëve të rajonit dhe ndjekjen e rekomandimeve të Platformës. Aktiviteti është pjesë e projektit "Të rinjtë në fokus II: Promovimi i rolit të të rinjve për paqen dhe sigurinë në Shqipëri".

Workshop në Universitetin Katolik të Lublinit, Poloni



Studentët të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", moren pjesë për 2 javë rresht në shkollën verore organizuar nga Universiteti i Katolik i Lublinit, Poloni në kuadër të workshopit "Teknikat laboratorike të përdorura në monitorimin e biomjekësisë dhe burimeve natyrore". Ky workshop është ndjekur nga 20 studentët të huaj që studiojnë jashtë territorit të Republikës së Polonisë në disiplinat: shkenca natyrore ose shkenca shëndetësore. Pas përfundimit të workshopit, pjesëmarrësit u pajisen me certifikatë të pjesëmarrjes me 4 pikë ECTS.